

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
OEVERIA - VLADA - GOVERNMENT

Nr./Br.

04-052-1202/2

Datum

06.01.2023

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA - POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT - ODELJENJE ZA INSPEKCIJE - DEPARTMENT OF INSPECTION

Referencë: **IPK/05012023/DI**

Datë: **05.01.2023**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për procedurën e planifikimit, inspektimit e raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së (2022-2024), si dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:

RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Menaxhimi i prokurimit dhe kontratave
Referenca	- 11/2022
Data e inicimit	- 01.07.2022
Data e raportimit	- 05.01.2023
Arsyet e inicimit	- Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit është paraparë me Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (nr. 04-052-261/9, datë 14.02.2022). Inspektimi ka qenë me interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse Policia është orientuar në shfrytëzimin racional dhe të drejtë të fondeve. Shuma të mëdha financiare shpenzohen për mallra, shërbime e projekte kapitale, në funksion të aktiviteteve operative dhe mbështetëse policore. Inspektimi ka paraqitur mundësi për të vlerësuar mënyrën se si shpenzohet paraja publike, por edhe llogaridhënien në realizimin e projekteve. Inspektimi synon të vlerësojë nëse sistemi financiar, prokurues e logjistik është i ekspozuar ndaj rreziqeve, që mund të kenë ndikim në punën, suksesin e imazhin policor. IPK ka rishikuar edhe nivelin e përbushjes së rekomandimeve të dhëna në inspektimin e kaluar, të pasqyruar në Raportin e inspektimit nr. 06/2021.
Objektivi	- Vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të prokurimit, - Vlerësimi i efikasitetit dhe leverdisë ekonomike lidhur me kontratat e lidhur, - Vlerësimi i përbushjes së detyrave nga menaxherët e projekteve, si dhe komisionet përkatëse në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve.
Metodologjia	- Takime - intervista me gjashtë (6) drejtues dhe bartës funksionesh: (a) Drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, (b) Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit, (c) Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, (d) Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës, (e) Drejtori i Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve, (f) Drejtori i Drejtorisë për Teknologji Informative dhe Komunikim; - Këqyrje - kontrole të: (a) Dosjeve të prokurimit, (b) Projekteve të realizuara (furnizime, shërbime dhe punë), (c) Ekzekutimit të pagesave; - Marrje dokumentesh, si:

	(a) Planet vjetore të prokurimit (2021/2022), (b) Raportet vjetore të kontratave të nënshkuara publike (2021/2022), (c) Dosjet e aktiviteve të prokurimit (9 sosh), (d) Dosjet e menaxhimit të kontratave, (e) Dosjet e ekzekutimit të pagesave.
Subjekti	- Departamenti për Shërbime Mbështetëse, me drejtoritë si në vijim: (a) Drejtoria e Prokurimit, (b) Drejtoria për Buxhet dhe Financa, (c) Drejtoria e Logjistikës, (d) Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve, (e) Drejtoria për Teknologji Informative dhe Komunikim.
Afatet	- Fillimi - 13.07.2022; - Përfundimi - 15.07.2022; - Periudha e mbulimit - dy (2) vitet e fundit dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik, - Rregullat Financiare.
Ekipi realizues	- Visar Shehu, Udhëheqës i Ekipit të inspektimit
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv i PPK-së
Datë	- 05.01.2023



Shkurtesat

AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktues
DNVDF	Deklarata e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve
DT	Dosja e Tenderit
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë
OE	Operatori Ekonomik
OSHP	Organi i Shqyrtimit të Prokurimit
RUOPP	Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
ZKA	Zyrtari Kryesor Administrativ
ZKA	Zyrtari Kryesor Financiar
ZPP	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:


- ✚ *AK ka dhënë sinjale pozitive se qëndron pas zotimeve se do të ndërmarrë veprimet e nevojshme drejt eliminimit të dobësive të identifikuar gjatë inspektimeve të kaluara lidhur me menaxhimin e prokurimit dhe kontratave. Rezulton një bilanc pozitiv i përmbushjes së rekomandimeve, pa marrë në konsideratë ato që lidhen me prokurimet nga fusha e mbrojtjes dhe sigurisë, të cilat nuk kanë qenë objekt i inspektimit.*
- ✚ *Krahas përmirësimit të performancës në një sërë fushash, ende mbetet prioritet angazhimi i vazhdueshëm në nxjerrjen planeve të qëndrueshme dhe realizimin e projekteve të planifikuara. Mjetet financiare shpesh destinohen, por nuk arrijnë të konvertohen në të mira materiale, andaj është me rëndësi trajtimi me kujdes i kërkesave me rëndësi jetike për organizatën. IPK kupton se në rrjedhën e duhur të realizimit të projekteve kanë ndikuar dhe faktorë të jashtëm, përfshirë, ndikimin e Pandemisë Covid - 19, mosfunksionimi i OSHP-së, etj.*
- ✚ *AK në të ardhmen duhet të ketë fokus në respektimin e bazës ligjore lidhur me caktimin e mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të menaxherëve të projekteve, të paraparë me ndryshimet e kohëve të fundit në legjislacionin dytësor të prokurimit publik.*



Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. *Duke u bazuar në performancën jo të kënaqshme të realizimit të projekteve në vitet e fundit, IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, që së bashku me drejtorinë vartëse të sigurojë një shkallë më të lartë të realizimit të planeve vjetore të prokurimit.*
2. *IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ që në të ardhmen të përcjellë ndryshimet ligjore mbi legjislacionin sekondar nga fusha e prokurimit publik, mbi caktimin e mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për t'u siguruar se do të ushtrohet një mbikëqyrje adekuate në realizimin e projekteve.*

Gjetjet kryesore:



1. Administrimi i aktiviteteve sipas hapave të prokurimit

1.1. Neni 8 i LPP obligon AK-të që të nxjerrin plane paraprake të prokurimit, kurse brenda 15 ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, të përgatisin dhe dorëzojnë në AQP, planet finale të detajuar mbi gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti i tillë synon t'i prokuroj gjatë vitit fiskal. Planet e prokurimit janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara kohore. Gjatë kontrollit të përmbajtjes së tyre, vërehet se në vitet e fundit, ato në masë të konsideruar nuk arrijnë të përmbushen. Në vitin 2020, rreth 34.2% e Planit Vjetor të Prokurimit është realizuar, derisa në vitin 2021 kjo përqindje është ngritur në 52.3%. Ende vërehet se ka prokurime të natyrës së njëjtë që janë administruar në dy apo më shumë raste. Prokurimet e tilla lidhen me blerjen e vajrave motorike, materialet higjienike, etj. Mos përmbushja e Planit është ndikuar dhe nga Pandemia Covid-19, kurse ndarjet e kërkesave me natyrë të njëjtë janë reduktuar krahasuar me vitet paraprake. Planet kanë paraparë shumicën e projekteve që janë mostruar për inspektim, kurse një numër i tyre edhe pse nuk janë përfshirë në Planet, lidhur me to është njoftuar AQP-ja para inicimit të procedurave prokuruese.

1.2. Neni 9 i LPP-së që rregullon përcaktimet e nevojave që duhet të përmbushen, potencon se *"para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i AK-së duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e vlerësimit të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e AK-së"*. Në këtë drejtim, ZKA dhe ZKF përgatisin dhe nënshkruajnë DNVDF-të. Në të gjitha rastet e përzgjedhura, janë nxjerrë këto Deklarata dhe formularët janë nënshkruar (aprovuar) nga personat përgjegjës.

1.3. Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit, e cila përlllogaritje duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent e të drejtë të fondeve dhe resurseve publike. Nga nëntë (9) dosje të kontrolluara, tre (3) kanë rezultuar me kontrata për furnizime¹, tre (3) me kontrata për shërbime² dhe tre (3) të tjera me kontrata për punë³. AK-ja bazuar në Planin e prokurimit ka përfshirë këto kontrata (në disa raste kur nuk janë planifikuar, është njoftuar AQP para fillimit të procedurës). DNVDF-të kanë parashikuar vlerën e kontratave, të cilat shuma pasqyrohen edhe tek Seksioni II - Fleta e të dhënave të tenderit në kuadër të dosjeve të tenderëve. Në parashikimin e vlerave të kontratave, AK përmes njërive kërkuese ka marrë parasysh çmimet e tregut lokal, si dhe çmimet e kontratave paraprake të nënshkruar nga AK. Nga nëntë (9) kontrata të kontrolluara, tre (3) prej tyre si kontrata për furnizime janë klasifikuar me vlerë të mesme⁴, tre (3) kontrata për shërbime janë klasifikuar me vlerë të mesme (2) dhe të vogël (1), si dhe tre (3) të tjera si kontrata për punë janë klasifikuar me vlerë të mesme (1) dhe vlerë të vogël (2). IPK-ja nuk ka vërejtur situata të mos ketë ndodhur klasifikim i duhur i kontratave në rastet e mostruara.

¹ Sipas nenit 16 të LPP, "Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga AK për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë".

² Sipas nenit 17 të LPP, "Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për shërbime është e barabartë me pagesën e përgjithshme dhe shumat e kompensueshme që do të paguhen nga AK sipas kontratës, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni".

³ Sipas nenit 18 të LPP, "Vlera e parashikuar e një kontrate të propozuar të punëve është e barabartë me çmimin e parashikuar që do të paguhet nga AK për të gjitha punët, shërbimet, produktet si dhe lëndët e tjera që mbulohen nga ajo; duke përfshirë - në rast të një kontrate të punëve - lëndët e nevojshme për ekzekutimin e kontratës në fjalë që duhet t'i vihen në dispozicion kontraktuesit të punëve nga AK".

⁴ Sipas nenit 19 të LPP, "Kontratë me vlerë të madhe konsiderohet me sa vijon: kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe, ose mund të pritët që të jetë e barabartë ose më e madhe se 125.000 €; ose kontrata për punë, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe se, ose që me arsye mund të pritët të jetë e barabartë me ose më e madhe se 500.000 €.

1.4. Përcaktimi i procedurës së prokurimit bazohet në vlerën e parashikuar të kërkesës dhe rrethanat në lidhje me kërkesën. Në nenin 33 përcaktohet se *”përveç nëse ndonjë dispozitë e neneve 34 - 37, posaçërisht e autorizon përdorimin e procedurave tjera të prokurimit, AK do të zgjedhë dhe përdorë procedurat e hapura ose të kufizuara gjatë zbatimit të aktiviteteve që kanë për qëllim dhënien e një kontrate publike”*. Nga nëntë (9) dosje të kontrolluara, në katër (4) nga to, AK-ja ka aplikuar procedurat e hapura, në tre (3) raste ka aplikuar procedurat për kuotimin e çmimeve dhe në dy (2) të tjera ka përdorur procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës. IPK ka pasur fokus të veçantë në këto të fundit dhe ka vërejtur se njëra procedurë e aplikuar përfshinë *“Furnizimin me pelerina shiu”* (214-21-7000-1-2-5), kurse tjetra, *“Furnizimin me vajra motori dhe AD Blue për automjetet e Policisë së Kosovës”* (214-21-5394-1-2-5). Tek njëri aktivitet, AK-ja ka zhvilluar negociatë me një OE, derisa tek aktiviteti i dytë, këtë procedurë e ka zhvilluar me dy (2) OE. Kjo është në harmoni me ligjin e prokurimit, por AK inkurajohet që në të ardhmen të promovojë konkurrencën me më shumë se një OE, duke synuar edhe reduktimin e kostove.

1.5. RUOPP detajizon se secili aktivitet i prokurimit kodifikohet me një numër të brendshëm prokurues për identifikim të shpejtë, monitorim aktiviteteve, për qëllime statistikore, etj. Numri i brendshëm i prokurimit përbëhet nga: identifikimi i AK, identifikimi i vitit të prokurimit, një numër serik prej tre (3) shifrave, që ri-starton në 1 çdo vit të prokurimit, kodi për llojin e prokurimit, kodi për parametrat e vlerës së parashikuar të kontratës së planifikuar ose konkursit të projektimit, si dhe kodi i procedurës që është përdorur. AK ka kodifikuar aktivitetet e prokurimit me numra, siç parashihet me rregullat në fuqi.

1.6. LPP në nenin 27 përcakton që *”AK do të hartoj një dosje të tenderit për secilën kontratë të parashikuar apo konkurs të projektimit, përveç nëse kontrata është me vlerë minimale”*. Sipas kësaj dispozite, *”dosja duhet të ofrojë informatat përkatëse lidhur me kontratën, përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës dhe informatat tjera përkatëse siç kërkohen nga Ligji ose siç i sheh të domosdoshme AK-ja”*. AK ka përgatitur DT duke përdorur formularët standard të aprovuar nga KRPP-ja, struktura e të cilëve përbëhet prej tre (3) pjesëve (procedura e tenderimit, draft kontrata dhe formulari i tenderit) dhe të njëjtat kanë qenë në dispozicion të OE-ve përmes platformës elektronike të prokurimit. DT-të janë përgatitur nga zyrtarët e prokurimit përgjegjës për përgatitjen e tyre, në gjuhët siç parashihet për kontrata përkatëse, para publikimit të Njoftimit të Kontratës. Lidhur me këtë të fundit, Ligji parasheh që *”kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e Njoftimit të Kontratës, DT-ja duhet të kompletohet para publikimit të Njoftimit të Kontratës”*. DT-të janë përgatitur me kohë, në formularët standard, në gjuhët zyrtare, varësisht nga vlera dhe procedura e aplikuar.

1.7. LPP-ja ka përcaktuar rregulla për caktimin e afateve për pranimin e tenderëve. *“Çfarëdo afati kohor i caktuar nga autoriteti kontraktues për pranimin e tenderëve, ose kërkesave për pjesëmarrje duhet të jetë i mjaftueshëm për t’iu dhënë operatorëve të interesuar ekonomik, kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar dokumentet në fjalë”*. Gjithmonë duhet pasur parasysh qëllimin dhe kompleksitetin e prokurimit dhe kontratën që jepet. Veç tjerash, duhet pasur parasysh dhe nivelin e vështirësive ose kompleksitetin e përgatitjes së tenderit. Ligji përcakton afate, që duhen respektuar nga AK-ja. Këto nuk lejohen të përcaktojnë afate që janë më të shkurtra se ato të përcaktuara, por u lejohet të vendosin afate më të gjata që t’u mundësojnë OE-ve, kohën e duhur për përgatitjen e ofertave. Ligji përcakton afatet, varësisht nga vlera e kontratës dhe procedura e prokurimit. Bazuar në njoftimet e kontratave dhe DT-të, afatet për pranimin e tenderëve qëndrojnë brenda rregullave

	<p>dhe se OE-të e interesuar kanë pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur tenderët e tyre, kjo nënkupton se nuk janë identifikuar dobësi lidhur me caktimin e afateve.</p> <p>1.8. Kriteret e përzgjedhjes⁵ përfshijnë kriteret e përshtatshmërisë, si dhe kriteret minimale të kualifikimit dhe paraqesin kërkesat e vëna nga një AK për OE-të që duhet përmbushur për të qenë i kualifikuar për dhënie të kontratës. Nuk janë hasur situata të vendosjes së kriterëve përzgjedhëse që eliminojnë konkurrencën. Po ashtu, edhe kriteret për dhënie të kontratës⁶ janë specifikuar në njoftimet e kontratave dhe në DT. Dosjet dëshmojnë se në të gjitha procedurat e inspektuara, AK ka specifikuar se do të shpërblejë OE-të që ofrojnë tenderët e përgjegjshëm me çmimet më të lira. Nuk janë identifikuar dobësi lidhur me vendosjen e kriterëve të përshtatshmërisë dhe përzgjedhjes.</p> <p>1.9. <i>“Gjatë një aktiviteti të prokurimit që shpie drejt dhënies së një kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, AK mund të kërkojë nga tenderuesit që të depozitojnë siguri për tender. Nëse AK-ja vendosë që të detyrojë depozitim të sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se 1% dhe jo më shumë se 3% e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1.000 €”⁷. Siguria e tenderit është mbulesë se OE ka ofruar informata të sinqerta, tenderi është valid për periudhën e kërkuar të validitetit, tenderuesi respekton kushtet para nënshkrimit të kontratës dhe do të përmbyllë kontratën. AK ka specifikuar se tenderuesit duhet të depozitojnë sigurinë e tenderit në shumën e përcaktuar. RUOPP në pikën 31 përcakton se “AK-të duhet të cekin në DT, periudhën e vlefshmërisë së tenderit të kërkuar dhe të specifikuar si numër i ditëve kalendarike nga afati i fundit për dorëzimin e tenderëve”. Kërkesa për periudhën e validitetit të tenderit parashihet varësisht nga vlera e kontratës. Periudha e validitetit ndryshon varësisht nga kompleksiteti i aktivitetit, por duhet të jetë e mjaftueshme që përbrenda saj të kryhet vlerësimi i tenderëve dhe dhënia - nënshkrimi i kontratës. Vihet në pah se AK ka specifikuar në njoftimet e kontratave dhe DT, kërkesat për periudhën e vlefshmërisë së tenderëve.</i></p> <p>1.10. Është synim i çdo AK-je që kontratat e lidhura me OE-të të përmbushen nën kushtet e përcaktuara. Në këtë drejtim edhe Ligji ka përcaktuar masa në funksion të AK-ve që të sigurohen që kontraktorët do të përmbushin efektivisht e kualitativisht kushtet e kontratave. Një nga to është depozitimi i një sigurie të ekzekutimit nga këta të fundit. Neni 63 i Ligjit (Siguria e ekzekutimit) përcakton që <i>“AK-ja mund të kërkojë nga operatori ekonomik, të cilin i është dhënë një kontratë që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës së tillë nëse (i) kontrata e tillë është kontratë e punëve, (ii) kontrata e tillë është kontratë e shërbimeve për krijimin e programeve kompjuterike, ose (iii) ekziston rreziku se thyerja e kontratës së tillë do t'i shkaktojë dëme substanciale autoritetit kontraktues dhe/ose mund të kërkojë që autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë”</i>. Kjo Siguri mbështetë përmbushjen e kontratës, kurse shuma e saj duhet të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. Njoftimet e Kontratave dhe DT kanë specifikuar qartë shumën e sigurisë së ekzekutimit, varësisht prej kohëzgjatjes së periudhave të realizimit të projekteve.</p>
--	--

⁵ Neni 51 i Ligjit përcakton që “AK duhet të theksojë në Njoftimin e Kontratës dhe të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit të gjitha kriteret e përzgjedhjes që një operator i interesuar ekonomik duhet të përmbushë për të konsideruar si i kualifikuar. AK duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundur, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin apo kërkesën për pjesëmarrje; dhe (ii) të përcaktojë në tërësi në dosjen e tenderit, të gjitha dokumentet dhe informatat në fjalë”.

⁶ Neni 52 përcakton që “AK në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit do të specifikojë kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret duhet të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm”.

⁷ Neni 57 i LPP-së (Sigurimi i tenderit).

1.11. Publikimet konsiderohen mjet i rëndësishëm i transparencës dhe përmes tyre njoftohen OE-të e interesuar për kontratat e parashikuara publike dhe rezultatet e aktiviteteve të prokurimit. LPP-ja në nenin 40 përcakton dispozitë të veçantë mbi Njoftimin e Kontratës dhe sipas saj, *”kur një AK synon të ndërmarr prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara, kuotim të çmimit ose konkurrese me negociata, do të përgatisë një njoftim të kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të Ligjit”*. Bazuar në dosjet e kontrolluara, AK-ja ka përgatitur Njoftimet e Kontratave në versionet zyrtare, të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik. Njoftimet janë hartuar në përputhje me formularët e miratuar nga KRPP.

1.12. Bazuar në informacionin e ofruar në Njoftimet për Kontrata dhe DT, tenderët janë dorëzuar në formë elektronike përmes platformës së ”e-prokurimi”, me çka sistemi ka gjeneruar regjistrat e ofertave të pranuar. Sipas legjislacionit në fuqi *”pas pranimit në sistemin elektronik, tenderët elektronik enkriptohen automatikisht nga sistemi duke përdorur çelësat publik të dy anëtarëve të komisionit të krijuara gjatë procesit të shpalljes së tenderit në sistemin e prokurimit elektronik”*. Lidhur me caktimin e komisionit të hapjes, RUOPP-ja përcakton që *”Zyrtari përgjegjës i aktivitetit të prokurimit do të caktoj komisionin e hapjes, jo më pak se 2 (dy) anëtarë, për hapjen e tenderëve”*. ZPP ka themeluar komisionet e hapjes së tenderëve, të përbërë nga anëtarë shfrytëzues të sistemit të prokurimit elektronik. Hapja e tenderëve është realizuar duke përdorur funksionalitetin e hapjes në sistemin elektronik të prokurimit. Sistemi ka gjeneruar procesverbalet e hapjes së tenderëve, që janë nënshkruar nga anëtarët e komisioneve dhe ZPP. Kopjet e procesverbaleve janë ngarkuar - publikuar në Sistem.

1.13. Neni 59 i Ligjit (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) përcakton që *”AK do të themelojë një komision vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave”*. ZKA në bashkëpunim me ZPP kanë themeluar Komisionet e vlerësimit të tenderëve në përbërje prej së paku tre anëtarëve. Komisionet kanë në përbërje anëtarë me aftësi të duhura, njohuri dhe përvojë relevante me kërkesat e prokurimit. IPK ka identifikuar më herët dobësi lidhur me formimin e komisioneve, ku ka hasur në kuadër të tyre në disa raste dhe zyrtar të përfshirë në hartim të specifikave teknike. Me kohë është rekomanduar që para aprovimit të komisioneve, të sigurohet se anëtarët e propozuar nuk janë pjesë e komisioneve të hartimit të specifikave teknike, termave të referencës, paramasave dhe paralogarive, ngase në të kundërtën përbën konflikt të interesit. Departamenti përkatës ishte zotuar se do të eliminojë dobësitë e tilla. Lidhur me këtë, AK-ja ka ndërmarrë veprimet e nevojshme në drejtim të eliminimit të këtyre dobësive.

1.14. RUOPP përcakton se *”procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se pesë ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve”*. Kontrolli i dosjeve vë në pah se ky veprim në të gjitha rastet ka filluar brenda periudhës së paraparë kohore. RUOPP ka përcaktuar dhe afatet e përmbylljes së procesit vlerësues. Sipas RUOPP *”Procedura për ekzaminim, vlerësim e krahasim të tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave*. IPK herën e kaluar ka identifikuar disa raste kur procedurat e vlerësimit nuk janë kryer brenda afateve ligjore dhe lidhur me këtë ka rekomanduar të ushtrohet kontroll në përmbylljen me kohë të proceseve vlerësuese. Departamenti përkatës është zotuar më parë se do të ndërmarr hapat e nevojshëm dhe rezultojn se komisionet në secilin rast të shënjestruar kanë përmbyllur këtë fazë brenda afateve ligjore.

1.15. Në inspektimin e kaluar IPK ka hasur një tender me çmim jo normalisht të ulët dhe lidhur me të ka dhënë vërejtje mbi procedurën e ndjekur të vlerësimit. Neni 61 specifikon se *”nëse një OE e dorëzon tender që është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, AK-ja do t'i dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim: (i) një ndarje të elementeve përbërëse të*

tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit”. IPK ka rekomanduar më parë lidhur me tenderët me çmime jo normalisht të ulëta, që të ushtrohet kontrolli i shtuar mbi komisionet që vlerësimi i këtyre tenderëve të respektojë rregullat në fuqi. Departamenti përkatës është zotuar se do të adresojë këtë problematikë. IPK-ja nuk ka hasur raste të mostrajimit të duhur të tenderëve me çmime jo normalisht të ulëta.

1.16. Sipas RUOPP, *”para se raporti i vlerësimit të aprovohet, ZPP kërkon nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, dëshmi për përmbushje të pranueshmërisë të specifikuar në DT dhe në Njoftimin për Kontratë. Pas pranimit të dëshmive të pranueshmërisë, ZPP nënshkruan Raportin vlerësues dhe ngarkon në platformë”*. Bazuar në dosjet e kontrolluar, ZPP u ka kërkuar OE-ve të rekomanduar për dhënie të kontratave nga komisionet, dëshmi për përmbushje të pranueshmërisë dhe pas pranimit të tyre, ka nënshkruar raportet e vlerësimit dhe i ka ngarkuar në platformë.

1.17. RUOPP përcakton se *“nëse AK ka marrë vendim për shpërblim të një kontrate publike duke përdorur procedurë të hapur, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuar pa publikim ose kuotim të çmimit ose ka administruar një konkurs projektimi, Zyrtari i prokurimit do të përgatis Njoftim mbi Vendimin e AK-së, pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar”*. AK-ja ka publikuar Njoftimet mbi Vendimet e AK-së në sistemin elektronik të prokurimit. Publikimet janë realizuar me anë të formularit standard që përmban Vendimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe Letrat standarde përkatëse për tenderuesit.

1.18. Neni 108/A i LPP-së ka përcaktuar dispozitë mbi zgjidhjen preliminare të mosmarrëveshjeve në fazën para nënshkrimit të kontratave. Qëllimi parësor i kësaj dispozite është për t’i vënë AK-të në pozicion për të rishikuar vendimet e tyre para përfshirjes së tyre në procedura gjyqësore, por edhe për t’iu lehtësuar OE-ve, qasje në mjete juridike. Dispozita hapë rrugë për reduktimin e rrezikut të konflikteve dhe numrit të ankesave në gjykata. Ky nen përcakton se *“çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i AK-së gjatë kryerjes së një aktivitetit të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqes një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues”*. Mbi këtë bazë, në disa prej aktiviteve, OE-të kanë ushtuar kërkesa për rishqyrtim pranë AK-së lidhur me vendimet për dhënie. Kërkesat janë parashtruar brenda afatit ligjor. Ligji për situatë të tillë përcakton që *“dorëzimi i një kërkesë për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezullojë zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar”*. Me rastin e pranimit të kërkesave, AK ka pezulluar aktivitetet deri në shqyrtimin e tyre dhe më pas ka njoftuar palët mbi pezullimin e procedurës. AK-ja ka nxjerrë vendimet përkatëse, të cilat u janë komunikuar parashtruesve të kërkesave e palëve të interesit. Asnjë prej vendimeve të AK-së nuk është atakuar në OSHP.


1.19. Neni 41 i Ligjit (Njoftimi për Dhënie të Kontratës) përcakton që *“nëse AK-ja ka dhënë një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, e negociuar pa publikim, ose procedurat e kuotimit të çmimeve, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas dhënies së kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin mbi dhënien e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji”*. Në inspektimin e kaluar ishte vënë re se në një aktivitet prokurimi, kontrata ishte nënshkruar para publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës. IPK ka njoftuar ZPP-në lidhur me obligimet që dalin nga respektimi i afateve kohore dhe nënshkrimin e kontratave. Departamenti përkatës është zotuar se do të ndërmerren hapat e nevojshëm drejt zbatimit me radhë të të gjitha rregullave dhe procedurave të publikimit dhe nënshkrimit të kontratave. Në këtë inspektim nuk janë hasur raste të tilla. ZPP ka nënshkruar kontratat në të gjitha rastet e mostruar. OE-të kanë plotësuar parakushtin për nënshkrim të kontratës duke dorëzuar sigurinë e ekzekutimit.

1.20. Neni 41/A lidhur me Njoftimin për Nënshkrimin e Kontratës, përcakton që *“Nëse AK ka nënshkruar një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura, të kufizuara, konkurruese me negociata, të negociuara pa publikim, procedurat e kuotmit të çmimeve, ose procedura me vlerat minimale, autoriteti i tillë kontraktues brenda dy (2) ditëve pas nënshkrimit të kontratës së tillë, do të përgatisë njoftimin për nënshkrimin e kontratës në gjuhët e cekura në nenin 13 të këtij ligji”*. Bazuar në dosjet e mostruara, AK në të gjitha rastet ka përgatitur Njoftimet për Nënshkrim të Kontratave dhe të njëjtat janë publikuar në sistemin elektronik të prokurimit, brenda afateve kohore. Kjo është një performancë pozitive pas rekomandimeve të dhëna gjatë inspektimit të kaluar, kur ishin hasur disa situata kur nuk janë respektuar afatet kohore për publikim të Njoftimeve për Nënshkrimin e Kontratave.

1.21. LPP i jep rëndësi mjeteve për promovimin e transparencës. Në këtë rrafsh, lidhur me aktivitetin prokurues, AK obligohet të mbajë evidencë ku pasqyrohen të gjitha veprimet e ndërmarra. Sipas nenit 10 të Ligjit, *“AK mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënien e kontratës ose konkursit të projektimit*. AK-ja obligohet të mirëmbajë Regjistrin përmbledhës të prokurimit mbi secilën procedurë, që përmban hapat e progresit të procedurës dhe rezultatet. Drejtoria e Prokurimit mbanë dosjet e prokurimit me dokumentacionin e nevojshëm. Dosjet përmbajnë kërkesat për iniciimin e aktivitetit të prokurimit dhe aprovimin, DT-të, njoftimet për kontratë, regjistrat e OE që pranojnë dosje, regjistrat e dorëzimit të tenderëve, vendimet mbi themelimin e komisioneve të hapjes e vlerësimit, procesverbalet e hapjes publike, deklaratat nën betim, ofertat e tenderëve të vlerësuar, raportet vlerësuese, njoftime për tender të pasuksesshëm/të eliminuar dhe të suksesshëm, njoftimet mbi dhënien e kontratës, kontratat, njoftimet për nënshkrimin e tyre, dokumentet e ankesave, etj. Këto dosje në formë Regjistri janë të plota, të renditur e të kompletuar. Regjistri ofron të dhëna të mjaftueshme, në bazë të të cilave lehtë mund të bëhet vlerësimi.

1.22. Raportimi i aktiviteteve të prokurimit paraqet mjet tjetër për promovimin e transparencës. RUOPP parasheh që në fund të vitit kalendarik, autoritetet të hartojnë Raport përmbledhës vjetor për çdo kontratë publike që është nënshkruar. Raporti përgatitet duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP dhe duhet dërguar brenda pesë (5) ditëve pas kërkesës me shkrim, por jo më vonë se më 31 janar. IPK ka siguruar raportet vjetore për kontratat publike të nënshkruara për vitet 2020-2021, ku vërehet se edhe pse janë reduktuar prokurimet me natyrë të njëjtë, duhet punuar në ndjekje të politikës së eliminimit të ndarjes së kërkesave. Raporti pasqyron projekte të realizuara, që nuk janë planifikuar me kohë. Edhe më parë, IPK ka cekë se këto dobësi shtrojnë nevojën për qasje serioze në planifikimin e projekteve.

1.23. Procedurën për caktim të menaxherit të projektit, përgjegjësitë e tij në nxjerrjen e Planit të menaxhimit të kontratës i rregullon RUOPP-ja. Kur flitet për bartjen e përgjegjësisë tek menaxheri i projektit, pasi të jetë nënshkruar kontrata nga palët, ZPP informon ZKA-në të emëroj zyrtarin përgjegjës për menaxhimin e kontratës. Pas pranimit të kontratës, ky zyrtar përgatitë Planin e menaxhimit të saj. IPK nuk ka identifikuar dobësi sa i përket caktimit të menaxherit dhe nxjerrjes së planeve të menaxhimit të kontratave. Kontrolli i dosjeve vë në pah se dosjet e prokurimit kanë planet e menaxhimit të kontratave. Nga janari i vitit 2021 ka qenë në fuqi Rregullorja që ka përcaktuar që përveç menaxherit të projektit, të caktohet edhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij. Nga inspektimi i dosjeve që lidhen me aktivitetet e prokurimit me vlera të mesme gjatë vitit 2021 (së paku 3 dosje) nuk është hasur të jetë caktuar ky autoritet, i përcaktuar me nenin 61.15 të RRUOPP-së, sipas të cilit *“ZKA do ta emërojë një person nga njësia kërkuese me shkathtësi dhe përvojë të duhur si menaxher të kontratës dhe një person nga njësia kërkuese ose nga institucioni si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës”*.

	<p>1.24. IPK-ja ka inspektuar respektimin e afateve kohore të realizimit të projekteve. Fillimisht duhet potencuar se për shkak të rrethanave të ndikuar nga Pandemia Covid - 19 edhe numri i projekteve ka qenë i reduktuar. Por bazuar në projektet që kanë qenë fokus inspektimi, nuk janë hasur situata të mosrespektimit të afateve kohore të përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga OE-të. IPK-ja më parë ka rekomanduar që të analizohet dhe vlerësohet ecuria e realizimit të projekteve kapitale, duke synuar identifikimin e dobësive të mundshme teknike, financiare e profesionale, në drejtim të ngritjes së efektivitetit dhe shkurtimeve të periudhës së realizimit të projekteve lidhur me kontratat për punë. Departamenti përkatës është zotuar se do të shtohen kontrollet nga njësia e monitorimit të kontratave, për t'u siguruar se projektet do të realizohen brenda afateve kohore.</p> <p>1.25. Nga kontrolli i dosjeve, vërehet se kontratat e arritura kanë paraparë në kushtet kontraktuale (kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta), dëmet e shkaktuara dhe vonesat në ekzekutimin e projekteve, qoftë për furnizime apo punë. Nuk janë hasur vonesa në realizimin e kontratave dhe nuk ka pasur penalizime. Ligji në fuqi lidhur me ekzekutimin e pagesave sipas kushteve të kontratave, parasheh që faturat duhet realizuar në afat prej 30 ditëve. IPK-ja nga dosjet e mostruara të pagesave ka vërejtur se pagesat janë ekzekutuar me kohë dhe në plotni.</p>
<p>Vlerësimi i përgjithshëm (përfundime)</p> 	<p>Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK-ja vlerëson se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ AK-ja ka lëvizur në masë të madhe në drejtim të eliminimit të dobësive, që janë identifikuar në të kaluarën. Fushat ku ka pasur përmirësim lidhen me përgatitjen e specifikimit teknik/termat e referencës/paramasat, përbërjen e komisioneve, vlerësimin e tenderëve brenda afateve, eliminimin e tenderëve me çmime jo normalisht të ulëta, etj. Fusha e planifikimit dhe realizimit të projekteve vazhdon të mbetet pikë e dobët në menaxhimin efektiv të projekteve. Nëse krahasohen planet me raportet e kontratave të nënshkruara pasqyrohet efektivitetet jo i duhur apo shkallë e pamjaftueshme e realizimit të projekteve. ✚ Lidhur me menaxhimin e projekteve ka një mobilizim në realizimin me kohë të tyre. Ka mungesë informacioni për caktimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të projekteve. Andaj lidhur me këtë, AK duhet të ndjekë ndryshimet në legjislacionin dytësor sa i përket fushës së menaxhimit të kontratave. ✚ Është vlerësuar përmbushja e rekomandimeve të dhëna, për të cilat është arritur pajtueshmëri në vitin e kaluar me strukturën përkatëse policore. Nga vlerësimet e këtij inspektimi rezulton se nga 15 rekomandime të dhëna në vitin 2021: <ol style="list-style-type: none"> (a) plotësisht janë përmbushur shtatë (7) rekomandime, (b) përgjithësisht (në masë të madhe) është përmbushur një (1) rekomandim, (c) pjesërisht është përmbushur një (1) rekomandim, (d) nuk është përmbushur një (1) rekomandim, (e) nuk janë vlerësuar pesë (5) rekomandime⁸.

⁸ Pesë rekomandime nuk janë vlerësuar meqë lidhen me prokurimet nga fusha e mbrojtjes dhe sigurisë. Prokurimet e kësaj natyre nuk kanë qenë objekt i këtij inspektimi.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	<i>Duke u bazuar në performancën jo të kënaqshme të realizimit të projekteve në vitet e fundit, IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, që së bashku me drejtorinë vartëse të sigurojë një shkallë më të lartë të realizimit të planeve vjetore të prokurimit.</i>	-I-	<i>Plani i prokurimit jo domosdo varet nga Drejtoria e Prokurimit, meqë gjatë vitit ndikojnë edhe shumë faktorë në realizimin e planit, por Drejtoria e Prokurimit synon në të ardhmen të reduktojë, minimizojë mosrealizimin e projekteve në bashkëpunim me njësitë inicuese brenda DSHM-së.</i>	<i>Në Vazhdimësi</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ që në të ardhmen të përcjellë ndryshimet ligjore mbi legjislacionin sekondar nga fusha e prokurimit publik, mbi caktimin e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për t'u siguruar se do të ushtrohet një mbikëqyrje adekuate në realizimin e projekteve.</i>	-I-	<i>Në lëndët e këtij viti janë eliminuar dobësitë e tilla, në vazhdimësi është përcjell ndryshimi i legjislacionit primar dhe sekondar për prokurim publik. Kemi zbatuar edhe Njoftimin e KRPP-së për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratave nga mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë.</i>	<i>Në Vazhdimësi</i>

Pasqyrë mbi përmbushjen e rekomandimeve nga gjetjet e inspektimit të mëparshëm (viti 2021) Inspektimi: Menaxhimi i prokurimit dhe i kontratave me operatorët ekonomik, nr. 06/2021				
Nr.	Rekomandimi	Komentet e strukturës policore (në original)	Plani i paraparë i Veprimit	Niveli i zbatimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon edhe njëherë Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse, që të nxisë një bashkëpunim dhe koordinim në kuadër të drejtorive që gjatë fazave para nxjerrjes së planeve të prokurimit, të jenë të përkushtuar në përgatitjen e projekteve, mbështetur në nevoja dhe kërkesa të organizatës, me synimin që planet e prokurimit të jenë orientuese dhe assesi formale.</i>	<i>Pajtohemi me rekomandimin dhe do të angazhohemi që të rritet bashkëpunimi në kuadër të drejtorive dhe njësisive kërkuese, sidomos para dhe gjatë përgatitjes së planit të prokurimit dhe gjatë tërë vitit do të monitorohet zbatimi i planit por zakonisht plani i prokurimit sidomos në fazën e dytë të vitit mund të pësojë ndryshime varësisht nga zhvillimi apo dështimi i projekteve, prioritetet dhe nevojat e reja.</i>	<i>Janar - Mars 2022</i>	<i>Pjesërisht</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë së Menaxhimit të Objekteve që të ushtrojë kontroll të shtuar mbi projektet e përgatitura nga sektorët e saj, në mënyrë që projektet e tilla të ofrojnë pasqyrë të qartë mbi punimet që priten të realizohen, duke i kushtuar kujdesin e duhur pjesës teknike të projekteve, përfshirë dhe specifikimet teknike, termat e referencës, paramasat dhe parallogaritë, në drejtim të ofrimit e krijimit të konkurrencës së mirëfilltë, trajtimit të barabartë dhe eliminimit të diskriminimit në radhët e operatorëve ekonomik.</i>	<i>Do të këshillohen dhe paralajmërohen të gjithë zyrtarët nga sektorët përkatës për të gjeturat dhe për implementimin e këtij rekomandimi dhe do të shtohet kontrolli dhe mbikëqyrja do të jetë më e afërt.</i>	<i>Menjëherë</i>	<i>Plotësisht</i>
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ që gjithmonë para se të rekomandojnë (aprovojnë) përbërjen e komisioneve të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, të sigurohen se anëtarët e propozuar nuk kanë qenë pjesë e komisioneve të hartimit të specifikave teknike, termave të referencës dhe paramasave dhe parrallogarive, ngase në të kundërtën përbën konflikt të interesit.</i>	<i>Do të këshillohen dhe paralajmërohen të gjitha njësitë kërkuese për të gjeturat dhe për implementimin e këtij rekomandimi dhe do të shtohet kontrolli.</i>	<i>Menjëherë</i>	<i>Plotësisht</i>

4.	<i>IPK-ja i rekomandon edhe njëherë Drejtorit të Prokurimit që në drejtim të menaxhimit të procesit të vlerësimit, të ushtrojë kontroll të shtuar mbi komisionet e vlerësimit të tenderëve, në mënyrë që procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të çmimeve të tenderëve të përmbillet brenda afateve të parapara kohore (në rast të kontratave komplekse nëse zgjatet afati i vlerësimit të tenderëve përtej 30 ditëve, të jepen arsyetimet e nevojshme në raportet e vlerësimit të tenderëve).</i>	<i>Janë marrë të gjitha veprimet për rekomandimin në fjalë që komisionet e vlerësimit të ofertave të përfundojnë vlerësimin sipas legjislacionit në fuqi prej 30 ditëve.</i>	<i>Menjëherë janë marrë të gjitha masat duke iu bërë me dije të gjithë zyrtarëve të prokurimit që janë pjesë e vlerësimeve të ofertave.</i>	<i>Plotësisht</i>
5.	<i>IPK-ja i rekomandon edhe njëherë Drejtorit të Prokurimit që të ushtrojë kontroll mbi komisionet e vlerësimit, që në të gjitha rastet e tenderëve jo normalisht të ulët, të respektojnë në përpikëri dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës (Tenderët jo normalisht të ulët), në drejtim të arritjes së kontratave serioze me operatorët ekonomik.</i>	<i>Janë marrë të gjitha veprimet për rekomandimin në fjalë që komisionet e vlerësimit të ofertave që në raste që ka çmime jo normalisht të ulëta (duke përfshirë artikull, pozicion), që neni 61 të LPP të zbatohet.</i>	<i>Menjëherë janë marrë masat duke ju bërë me dije zyrtarëve të prokurimit që janë në vlerësim.</i>	<i>Plotësisht</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe Drejtorit të Prokurimit që të sigurohen me rastin e vlerësimit të tenderëve dhe kontraktimit të punëve, që çmimet e kontraktuara të jenë çmime të tregut, duke mos dëmtuar buxhetin e organizatës.</i>	<i>Janë marrë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me çmimet e ofertave të jenë në harmoni me çmimet e tregut.</i>	<i>Menjëherë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit.</i>	<i>Përgjithësisht (në masë të madhe)</i>
7.	<i>IPK-ja i rekomandon edhe njëherë Zyrtarit Kryesor Administrativ që të ushtrojë një mbikëqyrje më efikase në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, duke i kushtuar rëndësi mbarëvajtjes së proceseve të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.</i>	<i>Do të këshillohen dhe paralajmërohen të gjithë zyrtarët përkatës do të shtohet kontrolli dhe mbikëqyrja.</i>	<i>Menjëherë</i>	<i>Plotësisht</i>
8.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm në respektimin e</i>	<i>Janë marrë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me këtë rekomandim që së pari bëhet njoftimi për dhënie të</i>	<i>Menjëherë janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit.</i>	<i>Plotësisht</i>

	<i>afateve për publikimin e njoftimeve për dhënie dhe nënshkrim të kontratave.</i>	<i>kontratës e pastaj të nënshkruhet kontrata.</i>		
9.	<i>IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ që të analizojë dhe vlerësojë ecurinë e realizimit të projekteve investive kapitale, duke synuar identifikimin e dobësive të mundshme teknike, financiare ose profesionale, në drejtim të ngritjes së efektivitetit dhe shkurtimit të periudhës së realizimit të projekteve lidhur me kontratat për punë.</i>	<i>Do të këshillohen dhe paralajmërohen të gjitha njësitë kërkuese për të gjeturat dhe për implementimin e këtij rekomandimi dhe do të shtohet kontrolli dhe monitorimi edhe përmes njësisë për monitorimin e kontratave dhe mbështetje ku do të kërkohen edhe raporte të rregullta periodike për ecurinë e projekteve.</i>		<i>Plotësisht</i>
10.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Menaxhimin e Objekteve që të ushtrojë kontroll të shtuar mbi menaxherët e projekteve dhe ekipet e mbikëqyrjes, në mënyrë që të respektohen në përpikëri kushtet e kontratave, dhe në drejtim të sigurimit të cilësisë së punimeve, të merret parasysh periudha e eliminimit të të metave, në mënyrë që vetëm pasi të ketë përfunduar periudha e tillë, më pas të lëshohen certifikatat përfundimtare të inspektimit.</i>	<i>Kemi filluar me implementimin e rekomandimit, duke shtuar kontrollin ndaj menaxherëve të kontratave, në mënyrë që të respektohen kushtet e kontratës.</i>	<i>Menjëherë</i>	<i>E pavlerësuar</i>